



KOMUNIKATË PËR MEDIA

Regjistrimi i Partisë: “Narodna Crnogorska Partija Kosova –NCPK” (Partia Popullore Malaziasë e Kosovës) - i hapur për shqyrtim publik

Prishtinë, 31 korrik 2009 – “Partia Popullore Malaziasë e Kosovës” me akronim NCPK, sot ka kompletuar kërkesat për regjistrim, të parashtruara nga Zyra për Regjistrim të Partive Politike pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vendimi përfundimtar për regjistrim të iniciativës politike do të merret pas përfundimit të periudhës shtatë (7) ditore, gjatë të cilës publiku mund ti shqyrtoj dokumentet e regjistrimit.

“Partia Popullore Malaziasë e Kosovës” është themeluar më 20 maj 2009 nga z. Llazar Radulloviq. Selija e saj gjendet në Çagllavicë.

Sipas programit kjo do të angazhohet për barazinë e të gjithë qytetarëve, për mbrojtjen dhe sigurimin e të drejtave të të zhvendosurve, kthimin në shtëpitë e tyre dhe angazhimin për pranimin dhe inkorporimin e malaziasve në Kushtetutën e Kosovës.

“Partia Popullore Malaziasë e Kosovës” do të angazhohet që në ambient demokratik të realizojë programin dhe qëllimet e saja për pjesëmarrjen dhe përfitimin e votuesve në zgjedhje.

Do të angazhohet për demokratizimin e jetës shoqërore, tolerancës, për barazinë dhe lirinë qytetare, për ruajtjen e identitetit nacional, besimit, kultures, gjuhës dhe mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve.

Zyrës për Regjistrim të Partive Politike i është dhënë përgjegjësia për regjistrimin e partive politike në Kosovë, nga Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.03/L-073.

Sipas Rregulles së KQZ-së nr.01/2008 për “Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike në Kosovë” *Secili mund ta kundërshtojë kërkesën në bazë të një ose më shumë arsyeve të parashtruara në nenin 5 me dorëzimin e kundërshtimeve me shkrim në Zyrë së bashku me çfarëdo të dhëne apo material që mbështetë kundërshtimet brenda shtatë (7) ditëve nga shpallja e kërkesës.*

Të gjitha materialet e regjistrimit duke përfshirë programin e partisë, statutin, dhe shenjën do të jenë në dispozicion për shikim dhe komente nga publiku.

Promovimi i transparencës për procesin e regjistrimit të partive politike është pjesë e procesit të KQZ-së.

Zyra për Regjistrim të Partive Politike gjendet në Rr. Agim Ramadani p.n në Prishtinë. Secili që dëshiron ti shikojë dokumentet mund të vijë në Zyrë prej orës 10-12 gjatë ditëve të rregullta të punës, nga data 31 korrik deri më 6 gusht 2009. Për informatë shtesë mund të kontaktoni Zyren për Regjistrim të Partive Politike / Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, +381 (0)38 551-807.